



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 628 Prot.

Tiranë, më 23.1. 2020

URDHËR

Nr. 24, datë 23.1. 2020

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ZHVILLIMIN E OLIMPIADAVE
KOMBËTARE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR DHE PJESËMARRJEN E
NXËNËSVE NË OLIMPIADAT NDËRKOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 26.04.2017, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar dhe pjesëmarrjen e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe Institucionet Arsimore të Arsimit Parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Besa SHAHINI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 28/1 Prot.

Tiranë, më 23.01. 2020

**RREGULLORE PËR ZHVILLIMIN E OLIMPIADAVE KOMBËTARE NË
ARSIMIN PARAUNIVERSITAR DHE PJESËMARRJEN E NXËNËSVE NË
- OLIMPIADAT NDËRKOMBËTARE**

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i Rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave, detyrave dhe përgjegjësive të institucioneve shtetërore për organizimin dhe zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar si dhe i të drejtave dhe detyrave të individëve që përfshihen në administrimin e realizimit të olimpiadave kombëtare.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "MASR" është Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- b) "QSHA" është Qendra e Shërbimeve Arsimore.
- c) "IAL" është Institucioni i Arsimit të Lartë.
- d) "DPAP" është Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.
- e) "DRAP" është Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar.
- f) "ZVAP" është Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar.
- g) "IA" është Institucioni Arsimor.
- h) "AMU" është Arsimi i Mesëm i Ulët.
- i) "AML" është Arsimi i Mesëm i Lartë.
- j) "PA" është përgjegjësi i administrimit të qendrës së zhvillimit të olimpiadave kombëtare.
- k) "AM" është administratori i mjedisit të zhvillimit të olimpiadave kombëtare.
- l) "AS" është administratori i sekretimit të testeve të olimpiadave kombëtare.
- m) "Mësuesi/trajneri" është mësues i institucioneve arsimore publike, ose pedagog i IAL-ve publike, që shoqëron nxënësit pjesëmarrës në olimpiadat ndërkombëtare.

Neni 3

Vendi që zënë olimpiadat në aktivitetin shkollor

Olimpiadat janë veprimtari të cilat kanë për qëllim të nxisin punën me nxënësit dhe të nxjerrin në pah prirjet dhe talentin e tyre në lëndë të veçanta. Në këto veprimtari marrin pjesë të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar të institucioneve arsimore publike dhe/ose private që plotësojnë kriteret dhe kushtet e përcaktuara në aktet nënligjore dhe në këtë rregullore.

Neni 4

Lëndët në të cilat zhvillohen olimpiadat

Olimpiadat zhvillohen në arsimin e mesëm të ulët (AMU) dhe në arsimin e mesëm të lartë (AML):

1. Në AMU zhvillohet olimpiada e lëndës matematikë për klasën e 9-të.
2. Në AML zhvillohen olimpiadat për lëndët: matematikë, fizikë, kimi, biologji, informatikë, gjuhë shqipe dhe letërsi, histori, gjeografi.

KREU II

INSTITUCIONET DHE STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR ZHVILLIMIN E OLIMPIADAVE KOMBËTARE

Neni 5

Institucionet dhe strukturat përgjegjëse

Institucionet dhe strukturat përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e olimpiadave kombëtare janë:

- a) Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- b) Qendra e Shërbimeve Arsimore.
- c) Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.
- d) Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.
- e) Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar.
- f) Institucionet Arsimore të Arsimit Parauniversitar.

KREU III

PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË OLIMPIADAVE KOMBËTARE

Neni 6

Procedurat e zhvillimit të olimpiadave kombëtare

Olimpiadat kombëtare zhvillohen në tri faza: Në nivel institucioni arsimor (IA), në nivel ZVAP-je dhe në nivel kombëtar, sipas "Udhëzuesit vjetor të zhvillimit të olimpiadave kombëtare, për nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, për vitin shkollor 2019-2020", nr.10205 prot., datë 15.11.2019.

I. Faza e parë zhvillohet në nivel institucioni arsimor. Në fazën e parë marrin pjesë nxënës të cilët kanë të paktën 8-të notën vjetore të klasës paraardhëse në lëndën ku do të marrin pjesë në olimpiadë. Kjo fazë zhvillohet sipas këtyre procedurave:

- a) ZVAP-et hartojnë testet e olimpiadave. Në çdo IA ngrihen komisionet për administrimin dhe vlerësimin e testeve. Këto komisione miratohen nga titullari i ZVAP-së.
- b) Data dhe ora e zhvillimit të olimpiadës afishohet në çdo IA jo më vonë se një javë përpara zhvillimit të saj.
- c) Olimpiadat zgjasin tri orë. Çelësi i zgjidhjes publikohet dy orë pas mbarimit të testimit, në ambientet e IA në të cilat zhvillohen olimpiadat dhe në faqen elektronike të IA dhe të ZVAP.
- d) Anëtarët e komisionit të administrimit dhe vlerësimit të testeve, fillimisht duhet të deklarojnë me shkrim që nuk kanë konflikt interesi.

- e) Rezultatet e vlerësimeve, brenda 7 ditëve nga data e zhvillimit të fazës së parë të olimpiadës, u bëhen të njohura nxënësve pjesëmarrës dhe dërgohen në ZVAP.
- f) Fitues të fazës së parë të olimpiadës janë nxënësit që kanë marrë jo më pak se 70% të pikëve në testim. Në ZVAP krahas rezultateve të vlerësimeve, dërgohen edhe testet e nxënësve fitues të vendit të parë, të dytë dhe të tretë.
- g) Rezultatet paraprake dhe rezultatet përfundimtare pas ankimimit të nxënësve, si dhe çdo dokument që lidhet me zhvillimin e olimpiadës janë objekt inspektimi i DRAP dhe DPAP dhe ruhen 6 (gjashtë) muaj në IA.

II. Faza e dytë zhvillohet në nivel ZVAP-je, me nxënësit fitues, që në fazën e parë kanë marrë jo më pak se 70% të pikëve. Kjo fazë zhvillohet sipas këtyre procedurave:

- a) Testet hartohen nga QSHA.
- b) Testet dërgohen me postë një ditë përpara zhvillimit të olimpiadës në ZVAP.
- c) Olimpiadat fillojnë në orën 10:00 dhe zgjatin tri orë.
- d) ZVAP cakton mjediset ku do të zhvillohet olimpiada dhe njofton nxënësit pjesëmarrës.
- e) Në çdo mjedis, në të cilin zhvillohet olimpiada, caktohet një Përgjegjës Administrimi (PA) dhe Administratorë të Mjedisit (AM) të propozuar nga ZVAP dhe të miratuar nga DRAP.
- f) PA dhe AM duhet të mos jenë mësues në shkollën e nxënësve fitues, si dhe mësues të lëndës në të cilën zhvillohet olimpiada.
- g) PA dhe AM nuk lejojnë hyrjen e personave të paautorizuar në mjedisin ku zhvillohet olimpiada.
- h) PA identifikon nxënësit pjesëmarrës në olimpiadë, një orë përpara fillimit të saj sipas listës së ardhur nga ZVAP.
- i) PA organizon ndarjen e AM-ve në mjediset ku do të zhvillohet olimpiada.
- j) Për çdo 15-20 nxënës caktohet një AM në mjedisin ku zhvillohet olimpiada.
- k) Zarfi me testet e olimpiadës hapet në kohën e fillimit të saj nga PA dhe AM, në prani të nxënësve.
- l) PA u shpërndan me procesverbal AM-ve testet për nxënësit.
- m) Sekretimi fillon pasi të ketë përfunduar shpërndarja e testeve.
- n) Për kryerjen e procesit të sekretimit të testeve, ZVAP cakton administratorët e sekretimit (AS), të cilët janë trajnuar për procesin.
- o) PA-të, AM-të, AS-të dhe nxënësit nuk lejohen të mbajnë telefon celular gjatë zhvillimit të olimpiadës.
- p) Monitorimi i olimpiadave në këtë fazë kryhet nga DPAP dhe DRAP.
- q) Testi dhe çelësi i zgjidhjes publikohen në faqen e internetit të QSHA-së një ditë pas zhvillimit të fazës së dytë.
- r) Komisionet e vlerësimit të testeve ngrihen me propozim të ZVAP, me miratim të DRAP dhe kanë në përbërje të tyre specialistë të këtyre institucioneve arsimore vendore edhe mësues të lëndës/ve me kategori kualifikimi më të lartë.
- s) Anëtarët e Komisionit të vlerësimit të testeve, fillimisht duhet të deklarojnë me shkrim që nuk kanë konflikt interesi. Këto deklarata ruhen për një vit në ZVAP.
- t) Rezultatet e vlerësimeve u bëhen të njohura nxënësve pjesëmarrës brenda 7 ditëve nga data e zhvillimit të testimit dhe depozitohen në ZVAP.

- u) Nxënësit që janë vlerësuar me mbi 70% të pikëve të mundshme, fitojnë të drejtën për të marrë pjesë në fazën e tretë të olimpiadës që zhvillohet në nivel kombëtar.
- v) Komisioni i vlerësimit, klasifikon nxënësit fitues të olimpiadës në nivel ZVAP, dhe i'a komunikon DRAP/ZVAP.
- w) Testet dhe vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve janë objekt inspektimi i DPAP dhe ruhen një vit në ZVAP.
- x) Pas përfundimit të fazës së dytë, si dhe afatit të ankimimit, sipas procedurës së parashikuar në nenin 9, rezultatet përfundimtare të nxënësve fitues dërgohen zyrtarisht nga ZVAP në DRAP, DPAP, MASR dhe QSHA, 15 ditë para fillimit të fazës së tretë të olimpiadës për lëndët përkatëse.
- y) Lista e nxënësve fitues të vendit të parë, të dytë dhe të tretë bashkë me testet e tyre dërgohen në QSHA.

III. Faza e tretë zhvillohet në nivel kombëtar dhe marrin pjesë nxënësit që në fazën e dytë janë vlerësuar me mbi 70% të pikëve. Kjo fazë zhvillohet në Tiranë, sipas procedurave të mëposhtme:

- a) Hartimi dhe vlerësimi i testeve të olimpiadës/ve për nxënësit e arsimit të mesëm të ulët (AMU) dhe nxënësit e arsimit të mesëm të lartë (AML) bëhet nga QSHA.
- b) Testi i olimpiadës, për secilën lëndë, për AML është i njëjtë për nxënësit e të gjitha klasave.
- c) Në varësi të numrit të nxënësve që do të marrin pjesë në këtë fazë, QSHA cakton qendrat ku do të zhvillohet olimpiada.
- d) ZVAP, Tiranë cakton përgjegjësit e administrimit (PA) dhe administratorët e mjedisit (AM) për zhvillimin e olimpiadës kombëtare, të cilët miratohen nga DRAP.
- e) ZVAP dërgon zyrtarisht në QSHA listën e PA-ve dhe AM-ve, 3 ditë përpara datës së zhvillimit të olimpiadës, për secilën lëndë.
- f) PA dhe AM duhet të mos jenë në kushtet e konfliktit të interesit, të mos jenë mësues të shkollës së nxënësve fitues, si edhe të lëndës në të cilën zhvillohet olimpiada.
- g) PA kryen identifikimin e nxënësve pjesëmarrës në olimpiadë, sipas listës së ardhur nga QSHA një orë përpara fillimit të saj.
- h) PA dhe AM nuk lejon hyrjen e personave të paautorizuar në mjedisin ku zhvillohet olimpiada.
- i) PA organizon ndarjen e administratorëve në mjediset ku do të zhvillohet olimpiada.
- j) Për çdo 15-20 nxënës caktohet një administrator i mjedisit (AM) të zhvillimit të olimpiadave kombëtare.
- k) PA-të, AM-të, AS-të dhe nxënësit nuk lejohen të mbajnë telefon celular gjatë zhvillimit të olimpiadës.
- l) PA u shpërndan me procesverbal AM-ve, testet për nxënësit pjesëmarrës në olimpiadën kombëtare.
- m) Testet sekretohen me barkod nga QSHA.
- n) Punonjësit e QSHA monitorojnë procesin e testimit dhe në përfundim marrin në dorëzim nga PA materialet e testimit, të cilat i dorëzojnë ato në institucion jo më vonë se tre orë nga orari i përfundimit të olimpiadës.
- o) Testi dhe çelësi i zgjidhjes publikohen në faqen e QSHA dhe MASR dy orë pas përfundimit të olimpiadës përkatëse.

- p) Testet dhe vlerësimi i përgjigjeve të nxënësve janë objekt monitorimi i MASR dhe ruhen 6 (gjashtë) muaj në QSHA.

KREU IV

KRITERET DHE PROCEDURAT QË NDIQEN PËR SHPALLJEN E FITUESVE NË OLIMPIADAT KOMBËTARE DHE PJESËMARRJEN E TYRE NË OLIMPIADAT NDËRKOMBËTARE

Neni 7

Kriteret dhe procedura e shpalljes së fituesve të fazës së tretë

1. QSHA shpall fituesit e olimpiadave kombëtare sipas këtyre kriterëve:
 - a) Fitues i vendit të parë, vlerësohet nxënësi që ka fituar 80% deri në 100% të pikëve totale të testit.
 - b) Fitues i vendit të dytë, vlerësohet nxënësi që ka fituar nga 70% deri në 79% të pikëve totale të testit.
 - c) Fitues i vendit të tretë vlerësohet nxënësi që ka fituar nga 60% deri në 69% të pikëve totale të testit.
 - d) Shpallja përfundimtare e fituesve bëhet jo më vonë se 7 ditë nga dita e zhvillimit të Olimpiadës.
2. QSHA dërgon në MASR, procesverbalin me emrat e nxënësve fitues, si dhe renditjen e tyre sipas barkodeve.
3. Përputhja e barkodeve me emrat e nxënësve bëhet në QSHA, në prani të përfaqësuesit të MASR.
4. Emrat e fituesve të olimpiadave kombëtare, publikohen në faqen e internetit të MASR dhe QSHA.

Neni 8

Procedurat që ndiqen për pjesëmarrjen e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare

Për pjesëmarrjen e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare, ndiqet procedura e mëposhtme:

- a) Nxënësit që kanë fituar tre vendet e para në olimpiadat kombëtare, në lëndët përkatëse në AMU dhe AML, kanë të drejtë të marrin pjesë në olimpiadat ndërkombëtare, të shoqëruar nga mësuesit/trajnerët, të caktuar me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- a) Pjesëmarrja e nxënësve në aktivitete/olimpiada ndërkombëtare, mbështetur në ftesën e organizatorëve, miratohet me urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- b) MASR në përputhje me buxhetin e hartuar dhe të miratuar për këtë veprimtari të arsimit parauniversitar, mund të mbështesë financimin e ekipit pjesëmarrës në olimpiadat ndërkombëtare.

Neni 9

Procedura e ankimit të nxënësve

Nxënësi ka të drejtë të bëjë ankim duke ndjekur këto hapa:

- a) Kërkesat për rivlerësimin e testit të nxënësit, për të 3 (tre) fazat e olimpiadës kombëtare, kryhen brenda 3 (tre) ditëve pas shpalljes së rezultateve.
- b) Për fazën e parë kërkesat për rivlerësim të testit depozitohen në ZVAP.
- c) ZVAP krijon një komision të posaçëm, i cili shqyrton kërkesën e nxënësit dhe kthen përgjigje me shkrim brenda 5 ditëve. Bashkë me përgjigjen, nxënësit i dorëzohet dhe fotokopja e përgjigjes së testit.
- d) Për fazën e dytë kërkesat për rivlerësim të testit depozitohen në ZVAP.
- e) ZVAP grumbullon ankimimet, dhe i përcjell ato bashkë me testet në DRAP, i cili i përcjell në QSHA.
- f) Ankimimet për fazën e dytë të olimpiadave kombëtare shqyrtohen nga QSHA.
- g) QSHA krijon një komision të posaçëm, të cilët duhet të jenë specialistë dhe mësues të lëndëve përkatëse. Ky komision shqyrton kërkesat e nxënësve dhe vendimet përkatëse i dërgon zyrtarisht brenda 5 ditëve në DRAP, i cili i përcjell në ZVAP. Ky i fundit i dërgon në IA.
- h) Për të shqyrtuar ankesën/at e nxënësve të fazës së tretë, MASR ngre një komision me përfaqësues të MASR, specialistë të QSHA, dhe mësues të lëndëve përkatëse.
- i) Komisioni shqyrton ankesën/at dhe vendimin përfundimtar, të firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit, e përcjell në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë të MASR-së, DPAP dhe QSHA. DPAP e përcjell vendimin përfundimtar në DRAP dhe ZVAP, kjo e fundit e përcjell në IA.

Neni 10

Promovimi dhe shpërblimi financiar i nxënësve që shpallen fitues të olimpiadave kombëtare dhe olimpiadave ndërkombëtare

- a) Nxënësit fitues në fazën e parë të olimpiadave kombëtare, pajisin me certifikata për vendin e fituar nga drejtoritë e institucioneve arsimore përkatëse.
- b) Nxënësit fitues në fazën e dytë të olimpiadave kombëtare, pajisen me certifikata për vendin e fituar nga DRAP/ZVAP në bashkëpunim me drejtoritë e institucioneve arsimore përkatëse.
- c) Nxënësit fitues në fazën e tretë të olimpiadave kombëtare (vendi i parë, i dytë, i tretë) dhe nxënësit fitues në olimpiadat ndërkombëtare, pajisen me certifikatë për vendin e fituar dhe shpërblehen financiarisht nga MASR me laptop/tabletë, libër etj.

MINISTRI
Besa SHAHINI

